

Mbi
Auditimin e Brendshëm
Ushtruar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Ndjekjes Investimeve të Infrastrukturës,
Njësia Monitorimit Shërbimeve Publike, Mirëmbajtja Pastrimit (Zona A-B)
-Bashkia Shkodër

Njësia e Auditimit Brendshëm – Bashkia Shkodër bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, planin vjetor të auditimit të brendshëm, zhvilloi një mision auditimi të plotë lidhur me veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Ndjekjes Investimeve të Infrastruktures, Njësia Monitorimit Shërbimeve Publike, Mirëmbajtja e Pastrimit (Zona A – B) - Bashkia Shkodër për periudhën 01.10.2013 deri 30.09.2018 nga auditimi rezultoi:

Përmbledhje ekzekutive:

Njësia Monitorimit Shërbimeve Publike, Mirëmbajtja e Pastrimit - Bashkia Shkodër vepron si njësi brenda Drejtorisë së Shërbimeve Publike Ndjekjes Investimeve të Infrastrukturës. Shërbimi i mirëmbajtjes së pastrimit të qytetit realizohet nga subjekt privatë, me të cilin është lidhur kontratë sipërmarrje shërbimi 5/vjecare. Shërbimi i pastrimit të qytetit është ndarë në dy zona “A” dhe “B”, realizimi i shërbimit mbikqyret nga dy supervizorë, të emëruar si “specialiste” pjesë e stafit të Drejtorisë së Shërbime Publike.

Nga auditimi i dokumentit të kontratës themelore dhe aneks kontratave rezultojnë këto mangësi: Kontrata themelore nuk ka të përcaktuar tek kushtet e vecanta, specifikimet teknike sipas objektit të shërbimeve dhe zërave të preventivit, nuk ka të përcaktuar vendndodhjen me sipërfaqe për mirëmbajtje, nuk ka planimetrinë e zonës, nuk ka hartë sipas listës së rrugëve, si dhe nuk ka grafik të detajuar të kryerjes së shërbimeve.

Aneks kontrata ka të përcaktuar objektin e kontratës, vleftën dhe afatin e realizimit të shërbimit, ka të bashkelidhur preventivin përkatës vjetorë (sipas periudhës). Në aneks kontratë mungojnë: kushtet e vecanta të kontratës, specifikime teknike sipas zërave të preventivit, të dhënat mbi zonën, vendndodhja, planimetri të zonës, hartë me listë të rrugëve, si dhe grafikët mujore/vjetor të detajuar të kryerjes së shërbimeve të pastrimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të supervizorit rezultojnë këto mangësi:

Dokumentacioni i përpiluar nga supervizori, mungojnë akt kontrolle dhe relacione mujore/vjetore. Nuk mbahen evidenca. Mungon grafiku vjetor dhe mujor i punës.

Proceset e punës nuk përshkruhen nga ana sasiore e cilësore. Evidencat e rajoneve nuk janë të protokolluar dhe nënshkruar nga personat përgjegjës

Nga auditimi i dokumentit të licensave të operatorit ekonomik, drejtuesit teknik dhe supervizorëve rezultuan këto mangësi: Nga verifikimi i dosjes personale të supervizorit të pastrimit të zonës A (pjesa jugore) rezultoi: vendim emërimi “supervizor i shërbimit pastrimit”, të

ketë diplomë në degën “agronomi e përgjithshme” me titull “agronom i lartë” . Në dosje mungon licenca e lëshuar nga QKL –ja për ushtrimin e veprimtarisë të mbikqyrësit të punimeve.

Nga verifikimi i dosjes pësonale të supervizorit të pastrimit të zonës B(pjesa veriore) rezultoi: vendim emerimi”supervizor i shërbimit të pastrimit”, të ketë diplomë në degën “Agronomi e lartë,dega Pemtari” me titull “agronom i lartë” . Në dosje mungon licenca e lëshuar nga QKL –ja për ushtrimin e veprimtarisë të mbikqyrësit të punimeve.

Nga verifikimi i dokumenteve të licensave të subjektit fitues rezulton të jëtë paisur me licensë nga QKB “leje mjedisore”, “Për evadim dhe transport të mbetjeve urbane” pa afat , si dhe QKL“leje” “Për grumbullim,transportim i mbetjeve urbane”. Në dosje mungon dokumenti i certifikimit të drejtuesit teknik të subjektit fitues..

Gjetje

Auditimi i kontratës themelore, lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Shkodër dhe sipermarrësit.

Gjetje nr 01 Kontrata themelore nuk ka të përcaktuar tek kushtet e vecanta, specififikimet teknike sipas objektit të shërbimeve dhe zërave të preventivit, nuk ka të përcaktuar vendndodhjen as me sipërfaqe për mirëmbajtje, as planimetri e zonës ,as hartë sipas listës së rrugeve, si dhe nuk ka grafik të detajuar të kryerjes së shërbimeve.

Gjetje nr 02 Preventivi përmbledhës nuk është specifikuar për cdo zë,ka shtim të zërave të preventivit vjetor të pa parashikuar në prevetivin përmbledhës dhe të pa kontraktuar

Gjetje nr 03 Kontrata nuk ka të bashkangjitur dhe të dokumentuar planin e menaxhimit të mbetjeve dhe strategjinë e mbledhjes së mbetjeve nga grupi monitorues i kontratës.

Gjetje nr.04 Kontrata nuk ka të bashkangjitur licensën (lejen mjedisore)e kontraktuesit, subjekti i ka lejet për ushtrim aktiviteti por mungonë dokumenti i certifikimit të drejtuesit teknik të subjektit (specialistit) sipas ligjit për QKL

Gjetje nr 05 Njësisë Monitoruese të Shërbimit të Pastrimit ,referuar nenit 40 të “kontratës themelore”i mungon dokumentimi i raportimit javore /mujore/vjetore i kontrollit mbi zbatimin e kontratës.

Gjetje nr 06 Dokumentacioni i përpiluar nga supervizori , nuk ka akt kontrole dhe relacione mujore/vjetore. Nuk mbahen evidenca.Grafiku i punës i pa konfirmuar nga mbikqyrësit.Proceset e punës nuk përshkruhen nga ana sasiore e cilësore. Evidencat e rajoneve nuk janë të protokulluar dhe nënshkruar nga personat përgjegjës

Gjetje nr 07 Nuk është bërë inventari dhe arkivimi i dokumentacionit për shërbimin e mirëmbajtjes pastrimit.

Gjetje nr 08 Në dosjen pësonale të supervizorit mungon përshkrimi i punës dhe licenca e lëshuar nga QKL

Monitorimi i shërbimit:

Gjetje nr. 09 : Referuar nenit 40 të “kontratës themelore” dhe neneve 23 e 24 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin” Drejtoria e Shërbimeve Publike duhej të kishte informuar me shkrim rregullishtë Kryetaren e Bashkisë në lidhje me shërbimin e mirëmbajtjes Pastrimit,si dhe duhej të kishte ngritur sistemin e monitorimit, por nga auditimi rezultoi se kjo drejtori nuk ka ngritur sistem monitorimi dhe kontrolli të brendshëm mbi ushtrimin e aktivitetit pastrimit.

Vleresimi i Kontrollit te Brendshem

Njësia Monitorimit të Mirëmbajtjes se Pastrimit,duhej të kishte ndjekur ecurine e punës së operatorit ekonomik dhe mbikqyrësit të punimeve si dhe njoftonte me shkrim drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe ky i fundit Kryetaren e Bashkisë lidhur me kryerjen e shërbimit ne mirëmbajtjen e pastrimit.

Rekomandime :

Rekomandimi nr.1 Bazuar ne argumentimet e trajtuar ne kete raport rekomandojmë në përmirësimin e formatit dhe përmbajtjes të kontratës themelore të re .

Rekomandimi nr. 2 Preventive analitik vjetor të analizohet , të specifikohet dhe nënshkruhet nga personat përgjegjës.

Rekomandim nr. 3 Ndryshimet në grafikun e shërbimit (javor dhe mujore) të analizohet dhe nënshkruhen nga personat përgjegjës.

Rekomandimi nr. 4 Informacioni i inspektoreve të lagjeve të kalojë nëpërmjetë protokollit dhe të konfirmohet nga personat përgjegjës.

Rekomandim nr. 5 Kontratës themelore ti bashkangjitet licenca e operatorit ekonomik,si dhe të kërkohet certifikimi i drejtuesit teknik të operatorit ekonomik për shërbimin përkatës.

Rekomandim nr. 6 Të përgatitet përshkrimi i punës për specialistet e shërbimit te pastrimit nga Drejtoria shërbimeve Publike dhe drejtoria Përsoneelit të Bashkisë.

Rekomandimi nr. 7 Mbikëqyrja e shërbimit të pastrimit të bëhet nga persona fizik ose juridik të jashtëm pajisur me liçensë përkatëse.

Rekomandimi nr. 8 Njësia e Monitorimit të Shërbimit të Mirëmbajtjes së Pastrimit,të hartojë dhe të miratojë planin e veprimit për kontrolle në terren të shërbimit pastrimit si dhe të informojë me shkrim Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike si dhe ky i fundit Kryetarin e Bashkisë lidhur me mbarëvajtjen e punës mbi aktivitetin e pastrimit te qytetit.

**Njësia Auditimit Brendshëm
Bashkia SHKODËR**